

AKT THEMELIMI

Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
“AD HOC” SH.P.K.

Sot, më datën 10.05.2024, **Z.Arjan BALAJ** i lindur në Stupë, Kosove me datë 06 nentor 1994 mbajtës i kartës së identitetit me numër ID1932936, banues në Kosove, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe **Z. Donald SHABANI**, i lindur në Elbasan, Shqipëri me datë 02 Tetor 1989, banues në Shqipëri, mbajtës i kartës së identitetit me numër I91002079M madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar vendosën të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “AD HOC” Sh. P. K. si më poshtë vijon

Neni 1

Personat fizikë të sipërpërmendur, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh. P. K.) me emërtimin “AD HOC”.

Ortakë të kësaj shoqërie janë **Z.Arjan BALAJ, Z. Donald SHABANI**

Administrator i kësaj shoqërie caktohet **Z. Donald SHABANI** për një periudhë deri në 5 vjet.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

Neni 2

Shoqëria “AD HOC” gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**Sh. P. K.**”. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë “AD HOC” SH.P.K. është : **Lagjja 4, Rruga Fetah Billaca, Pallati 1133, Kati i tretë, Zona Kadastrale 8514**

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

Neni 3

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe pa afat të përcaktuar.

Neni 4

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

- Tregti me pakice dhe shumice të pijeve alkoolike (vere).

Kapitali i shoqërisë është 100.000 Leke. Kapitali i shoqërisë ndahet në një numër kuotash në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri ku çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri, kuota këtu të shlyera si më poshtë:

Z.Arjan BALAJ zotëruese e një kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 leke që përbën 50% të kapitalit të shoqërisë.

Z. Donald SHABANI zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 leke që përbën 50% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jete në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme apo të drejta). Ortaket përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundëjt të treteve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 6

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakëve të saj.

Neni 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

Neni 8


Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

Neni 9

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

ORTAKET E SHOQERISE

Arjan BALAJ

Arjan Balaj 

Donald SHABANI

Donald Shabani 